



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**

---

**UDHËZIM ADMINISTRATIV MD - NR. 20/2023<sup>1</sup>**  
**PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË PËR VLERËSIM DHE**  
**KLASIFIKIM TË BURGOSURVE**

---

<sup>1</sup> Udhëzim Administrativ MD - Nr. 20/2023, për funksionimin e njësisë për vlerësim dhe klasifikim të burgosurve i nënshkruar nga Ministrija e Drejtësisë më datë 26.12.2023

**Ministrja e Ministrisë së Drejtësisë,**

Në mbështetje të neni 17 paragrafi 9 Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, në bazë të neni 11 paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011,

Nxjerrë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV  
MD-NR. 20/2023  
PËR FUNKSIONIMIN E NJËSISË PËR VLERËSIM DHE KLASIFIKIM TË  
BURGOSURVE**

**KAPITULLI I  
DISPOZITA TE PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i funksionimit të Njesisë për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve (në tekstin e mëtejme: NJVKB) duke përfshirë vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për hartimin e planit individual për ekzekutimin e dënimit.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ do të zbatohet nga NJVKB, dhe të gjitha Institucionet Korrektuese dhe Njësitë tjera në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

**KAPITULLI II  
FUNKSIONIMI I NJËSISË PËR VLERËSIM DHE KLASIFIKIM TË  
BURGOSURVE**

**Neni 3  
Kompetencat e Njesisë për Vlerësim dhe Klasifikim të të Burgosurve**

1. Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve e bënë vlerësimin individual të rrezikut dhe të nevojave për të dënuarit pas pranimit në Institucion Korrektues për mbajtje të dënimit.
2. Vlerësimi nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet në institucionin korrektues ku është vendosur NJVKB.
3. Njësia për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit për të dënuarit të cilët janë pranuar në Institucionin Korrektues bënë vlerësimin individual të rrezikut dhe të nevojave përmes mekanizmave të saj.
4. Pas procesit të vlerësimit, zyrtari vlerësues harton planin individual për zhvillimin dhe aftësimin edukativ dhe profesional gjatë mbajtjes së dënimit sipas specifikave të secilit të dënuar.
5. Institucioni Korrektues ku gjendet i dënuari, mund të kërkoj nga Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim, të bëjë rivlerësimin e planit individual për shkak të nevojave të dënuarit dhe rrethanave tjera të reja të krijuara, pas rivlerësimit nëse i dënuari duhet të transferohet në një Institucion tjetër. Njësia e Vlerësimit dhe Klasifikimit i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të vendos për transfer.
6. Vlerësimi dhe klasifikimi i të burgosurve bëhet nga zyrtarët vlerësues të trajnuar.

#### **Neni 4** **Procedura e Vlerësimit**

1. Të dënuarit me aktgjykim të plotfuqishëm do të pranohen në institucionin korrektues ku është e vendosur Njësia e Vlerësimit dhe Klasifikimit të Burgosurve.
2. Institucioni Korrektues, pas pranimit të dënuarve dërgon në NJVKB regjistrin me të dhënat e të dënuarve me aktgjykim të plotfuqishëm.
3. Zyrtari vlerësues pas pranimit të rastit e bënë vlerësimin e rrezikut dhe nevojave si dhe planifikimin e ekzekutimit të dënimit sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo me vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimit të të dënuarit në Institucion Korrektues.
4. Përbashimisht, në raste të jashtëzakonshme, udhëheqësi i NJVKB mund të zgjatë afatin e vlerësimit deri në pushimin e këtyre rrethanave të krijuara për zgjatjen e afatit.
5. Zyrtari vlerësues pas përfundimit të vlerësimit dhe planifikimit individual të ekzekutimit të dënimit, rastin e prezanton tek Udhëheqësi i NJVKB.
6. Udhëheqësi i NJVKB i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së për vendosjen e të dënuarit në Institucionin Korrektues përkatës.
7. Plani individual i dënimit i cili është nënshkruar nga i dënuari, nënshkruhet edhe nga zyrtari vlerësues dhe Udhëheqësi i NJVKB.
8. Drejtori i Përgjithshëm vendos lidhur me rekomandimin për vendosjen.

## **Neni 5**

### **Roli i Njësisë për Vlerësimin dhe Klasifikimin të Burgosurve**

Roli i NJVKB është që të bëjë vlerësimin e rrezikut, të identifikoj nevojat dhe të përcaktoj veprimet në mënyrë që i dënuari të inkuadrohet në programet e trajtimit individual me qëllim të arritjes së riedukimit, risocializimit dhe ri integritit në shoqëri.

## **Neni 6**

### **Faktorët për vlerësim të rrezikut dhe të nevojave**

1. Vlerësimi i rrezikut për recidivizëm bëhet duke u bazuar në këta faktorë:

- 1.1. e kaluara kriminale;
- 1.2. modeli i personalitetit antisocial;
- 1.3. qëndrimet pro kriminale;
- 1.4. shoqëria pro kriminale;
- 1.5. familja, rrethanat familjare;
- 1.6. shkollimi;
- 1.7. koha e lirë;
- 1.8. abuzimi me substanca dhe shkalla e varësisë prej tyre.

2. Analizimi i faktorëve të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni bëhet duke u bazuar në burimet e informacioneve të pranuar nga institucionet relevante, intervista me të dënuarin si dhe instrumente tjera për vlerësim.

## **Neni 7**

### **Planifikimi i ekzekutimit të dënimit**

1. NJVKB bënë planifikimin e ekzekutimit të dënimit, duke u bazuar në faktorët dhe nevojat si ne vijim:

- 1.1. vepra dhe gjatësia e dënimit;
- 1.2. faktorët mbrojtës;
- 1.3. faktorët e rrezikut;
- 1.4. siguria e të dënuarit;
- 1.5. nevojat e të dënuarit;
- 1.6. qëllimi i planit të dënimit;

- 1.7. veprimet bazuar në programet e parapara që duhet të bëhen për të dënuarin gjatë procesit të mbajtjes së dënimit.
2. Planifikimi i ekzekutimit të dënimit bëhet nga zyrtari që ka bërë vlerësimin dhe klasifikimin në bashkëpunim me të dënuarin, duke u bazuar në nevojat e të dënuarit si dhe programet dhe aktivitetet më të përshtatshme rehabilituese që ofrohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.
3. Plani i ekzekutimit të dënimit i përgatitur nga zyrtari për vlerësim dhe klasifikim nënshkruhet edhe nga i dënuari.
4. Planifikimi i ekzekutimit të dënimit bëhet për të gjithë personat e dënuar
5. Përjashtimisht planifikimi i ekzekutimit të dënimit bëhet edhe për personat e dënuar me me pak se gjashtë (6) muaj dënim me burgim, të cilët janë recidivist, kanë të kaluar kriminale ose faktorë të tjerë të rrezikut.
6. Planifikimi i ekzekutimit të dënimit zbatohet nga zyrtarët përkatës dhe monitorohet nga menaxheri i rastit i cili caktohet nga institucioni korrektuese ku dërgohet i dënuari.
7. Menaxheri i rastit, gjatë monitorimit mbanë shënime për mbarëvajtjen apo ngecjen e zbatimit të planit të dënimit dhe për këtë e njofton me shkrim Udhëheqësin për Programe dhe Regjime të Qendrës Korrektuese ku është i vendosur i dënuari.
8. NJVKB për vlerësimin e të dënuarve i përdorë dy forma të vlerësimit, si vlerësimin e gjatë dhe vlerësimin e shkurtë.
9. Zyrtari vlerësues varësisht nga faktorët e rrezikut dhe të nevojave vendos për formën e vlerësimit.
10. Zyrtari vlerësues pas përfundimit të vlerësimit dhe planit të ekzekutimit të dënimit, dosjen e vlerësimit ia dërgon Udhëheqësit të NJVKB.
11. Udhëheqësi i NJVKB pas shqyrtimit të dosjes së vlerësimit, i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së për vendosjen e të dënuarit në Institucion Korrektues.
12. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së në Institucionin Korrektues është përfundimtar.

## **Neni 8**

### **Baza e të dhënave**

NJVKB harton raportet e vlerësimit dhe planifikimit të ekzekutimit të dënimit duke përdorur bazën e të dhënave të SHKK-së.

## **Neni 9**

### **Arkivimi i dosjeve të dënuarve**

1. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, klasifikimit dhe planifikimit të ekzekutimit të dënimit një kopje fizike e dosjes së të dënuarve kompletohet, regjistrohet dhe protokollohet me protokollin e brendshëm të NJVKB-së dhe vendoset në hapësirën e caktuar në arkivë.

2. Në arkivë mund të kenë qasje vetëm zyrtarët nga NJVKB dhe auditorët.

**Neni 10**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen të fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ MD-Nr. 13/2023 për funksionimin e njësisë për vlerësim dhe klasifikim të të burgosurve.

**Neni 11**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

**Albulena Haxhiu**

---

**Ministre e Drejtësisë**

26/12/2023